

VM 39-95-2018

P.nr.53/2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR], i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamentit i Përgjithshëm PP/II.nr.101-4/18 të datës 11.01.2018, për veprën penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.10.04.2018 solli:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj Ferizaj -Departamentit i Përgjithshëm PP/II.nr.101-4/18 të datës 11.01.2018, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] lindur me datë [REDAKTUAR], në [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së mesme ekonomike, me profesin vozitës me numër personale të letërnjoftimit [REDAKTUAR], mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse - me datën 24.10.2016, rrethë orës 16:00, në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë, te mobilerija [REDAKTUAR] duke drejtuar automjetin transportues të markës "Skania" me targë të regjistrimit [REDAKTUAR] me pjesen e sipërme të rimorkios, nga pakujdesia ka dëmtuar instalimet publike, e ka këputur kabllon e rrjetit elektrik, të cilën e furnizon me rrymë mobilerinë [REDAKTUAR], duke shkaktuar çrregullim në furnizimin me energji elektrike, dëmi i shkaktuar sipas të dëmtuarit [REDAKTUAR] sillet rreth 200 € uro,-

- me të cilën kreu veprën penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin [REDACTED] i shqiptoi dënimin në shumën prej 100 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

I dëmtuari [REDACTED] nga Ferizaji rruga [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari të paguaj edhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamentit i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.101-4/18 të datës 11.01.2018, ka akuzuar [REDACTED] nga [REDACTED], për veprën penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe në aktakuzë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës dhe ato nga kallximi penal të paraqitur nga Policia e Kosovës-Stacioni Policon në Ferizaj, me numër të rastit 2016-CF-2527, të datës 19.12.2017, deklarata e të dëmtuarit [REDACTED] dhënë në polici me datën 24.10.2016, ku gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së ,të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaj rruga [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e viktmave të krimit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.53/2018 i dt.10.04.2017

Bashkëpun.prof.
Mimoza Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.